

Mishngrënësit e mëdhenj

Ariu, ujku dhe rrëqebulli, miqtë tanë të ardhshëm apo armiqtë e përjetshëm?

Aleksandër Trajçe - PPNEA
Olsi Qazimi - PPNEA

Para rreth një viti në një nga televizionet private shqiptare u trumbetua si një lajm i bujshëm, kapja e një ujku "vrasës" në zonën e Kelmendit në Malësi të Madhe. Bariu, i kishte kapur ujkun me lak, e mbante i htrënguar për veshësh, me një pamje eroike në fytyrë dhe, teksa pamjet ransmetoheshin, spikeri e jepte lajmin me notat e një fitoreje dhe triumfi të madhërishtëm. Njeriu kishte fituar mbi bishën...

Por a është vallë ky imazhi që



duhet të kemi për këto krijesa që kanë banuar tokën prej qindra mijëra vjetësh?

Shqipëria edhe pse një vend me sipërfaqe të vogël në Evropë, ka fatin të ketë në pyjet e saj, tre mishngrënësit e mëdhenj të Evropës: ariun, ujkun dhe

rrëqebullin. Në shumë vende të Evropës Perëndimore dhe Qendrore këto kafshë janë zhdukur apo rralluar shumë. Shkak për këtë kanë qenë zhvillimi social-ekonomik i këtyre vendeve, prishja e habitatit, por mbi të gjitha persekutimi dhe gjuetia e ndërmarrë nga njerëzit. Konflikti njeri-mishngrënës është i hershëm, që në kohën e lindjes së blegtorisë. Për shkak të sulmeve që grabitqarët e mëdhenj bënin mbi bagëti, njeriu gjithmonë i ka vrarë, helmuar apo mbytur. Si pasojë e kësaj ariu, ujku dhe rrëqebulli, në shumë vende shkuan drejt zhdukjes dhe, bashkë me ta, humbi një vlerë e paçmueshme e biodiversitetit të këtyre vendeve.

Por sot gjendja ka ndryshuar.

Mendimi për mishngrënësit e mëdhenj ka pësuar një transformim rrenjësor. Ata nuk shihen më si armiq dhe konkurrues të njeriut, por si një element kyç dhe i domosdoshëm i ekosistemit. Në mjaft vende të zhvilluara të Evropës si Francë, Zvicër, Gjermani, Norvegji, etj. kanë filluar me kohë programe për rikuperimin dhe mbrojtjen e plotë të mishngrënësve të mëdhenj. Prania e këtyre kafshëve është mëse e nevojshme jo vetëm sepse janë një pasuri e biodiversitetit, por edhe pse tregojnë për një ekosistem të shëndetshëm dhe në ekuilibër. Duke qenë në majë të piramidave ekologjike, ariu, ujku dhe rrëqebulli janë një tregues

mjaft i rëndësishëm mjedisor dhe çdo masë e marrë për mbrojtjen apo ruajtjen e tyre pasqyrohet dhe në nivele të tjera të ekosistemit duke çuar në përmirësimin e gjendjes së tij.

Në Shqipëri, mishngrënësit e mëdhenj nuk janë zhdukur kurrë dhe vazhdojnë të jenë banorë të pyjeve tona edhe sot. Por mendimi për ta ende nuk ka ndryshuar dhe gjendja e tyre është kritike. Edhe pse të mbrojtur nga ligjet shqiptare këto kafshë vazhdojnë të persekutohen në masë, pa asnjë kriter apo pengesë. Situata paraqitet tejet



alarmante sidomos për rrëqebullin, popullata e të cilit numëron jo më shumë se 25 individë në gjithë territorin e Shqipërisë. Rrëqebulli që jeton në Shqipëri, përveç të tjerave, bart vlera të mëdha ekologjike pasi konsiderohet si një subspecie më vete (*Lynx lynx martinoi*) i quajtur Rrëqebulli i Ballkanit me përhapje vetëm në Ballkanin Jugperëndimor, kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni. Ariu dhe ujku, edhe pse më të shumtë në numër nuk

mund të quhen me fat, pasi me këto ritme që po vazhdon gjuetia e paligjshme dhe persekutimi i tyre, fundi duket i afërt.

Kohët e fundit është shfaqur një interesim i përgjithshëm nga shumë organizata ndërkombëtare dhe kombëtare për gjendjen e mishngrënësve të mëdhenj në Shqipëri. Fokusi kryesor është rrëqebulli, i cili është dhe më i rrezikuari, por në planin e përgjithshëm konsiderohen të tre grabitqarët. Tashmë ka filluar një projekt shumëpalësh për mbrojtjen dhe rikuperimin e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit. Në këtë nismë marrin pjesë organizata ndërkombëtare si Grupi Specialist i Maceve të Egër të Botës (IUCN SSC/Cat Specialist Group), Organizata Zvicerane për Menaxhimin e Mishngrënësve të Mëdhenj (KORA), Fondi Evropian për Trashëgiminë Natyrore (Euronatur) dhe Instituti Norvegjez për Kërkimet Mjedisore (NINA). Në nivelin rajonal, implementuese të projektit do të jenë Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe Shoqata Ekologjike Maqedonase (MES). Gjithashtu është ngritur një Qendër për Monitorimin e Mishngrënësve të mëdhenj ku bashkëpunojnë Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në

Shqipëri (PPNEA) dhe Shoqata për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë (ASPBM). Këto nisma përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt shpëtimit dhe ruajtjes së mishngrënësve të mëdhenj e ardhmja e të cilëve gjendet në udhëkryq.

E megjithatë është e rëndësishme përfshirja e sa me shumë organizatave qeveritare dhe jo qeveritare në Shqipëri, sidomos bashkëpunimi me federatën e gjuetarëve për të eliminuar ose për të ulur në nivele të pranueshme ndikimin e gjuetisë së paligjshme kundrejt faunës së egër. Forcimi i mjeteve ligjore dhe zbatimi i dispozitave në kuadër e faunës në përgjithësi dhe të mishngrënësve të mëdhenj në veçanti, si dhe sensibilizimi i publikut të gjerë



si në zonat rurale dhe ato urbane do të jepte një ndihmesë të madhe për çështjen.

Thirrja është e qartë: Shpëtimi i faunës së egër është detyrim që kemi ndaj vetes dhe brezave të ardhshëm.